



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 30.3.2023

Nr: 220

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E Z. EDUART MUHAMET NALLBANI SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 30.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Komiteti Nismëtar për regjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë

OBJEKTI: Regjistrimi i z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 70 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Me vendimin nr. 145, datë 8.3.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar Komitetin Nismëtar i cili do të organizojë punën për paraqitjen e z. Eduard Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Data: 30.3.2023 Nr: 220
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Me shkresën nr. 1903 prot., datë 24.3.2023, komiteti nismëtar ka paraqitur në KQZ nënshkrimet mbështetëse të 109 (njëqind e nëntë) zgjedhësve.

Bashkëlidhur është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë vijon:

- Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie të posaçme, Model KQZ-04-08,
- Jetëshkrim i kandidatit, Model KQZ-04-10,
- Listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore që mbështesin kandidatin të nënshkruar prej tyre sipas Model KQZ-04-01, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit,
- Formulari i vetëdeklarimit,
- Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit, Model KQZ-00-31.

Neni 70, pika 3 përcakton se Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve rezulton se zona zgjedhore Bashkia Tiranë ka 699 748 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 70 të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1% të listës së zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, është 7 000 (shtatë mijë) zgjedhës.

Pas verifikimeve përkatëse të dokumentacionit në tërësi për regjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 70 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 70 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

V E N D O S:

1. Mosregjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI